

# Si e Kuptojnë dhe Vlerësojnë Demokracinë Evropianët:

Rezultatet kryesore nga Raundi 6  
i Sondazhit Social Evropian

Seritë e  
raportimeve  
të rezultateve  
kryesore të SSE-s

Edicioni

4

## Përdorimi i të dhënave të Sondazhit Social Evropian Të dhënat dhe dokumentacioni

Hulumtimi Social Evropian Konzorciumi Evropian i Kërkimeve të Infrastrukturës - ESS ERIC - siguron qasje falas në të gjitha të dhënat dhe dokumentacionin e saj. Këto mund të shfletohen dhe të shkarkohen nga faqja e saj e internetit: [www.europeansocialsurvey.org](http://www.europeansocialsurvey.org).

Nisma të veçanta janë zhvilluar për të promovuar qasjen dhe përdorimin e grupit të të dhënave gjithmonë në rritje, duke përfshirë të dhënat e EduNet dhe NESSTAR, të cilat janë të disponueshme nëpërmjet faqes së internetit të Sondazhit Social Evropian (më tej SSE).

### EduNet

EduNet është një platformë elektronike e SSE-s për tu përdorur në mësimnxënie në arsimin e lartë. Platforma ofron shembuj praktikë dhe ushtrime të hartuara për të orientuar përdoruesit përgjatë procesit të hulumtimit, nisur nga problemi teorik deri në interpretimin e rezultateve statistikore. Deri më tani, të dhënat e SSE-s mund të përdoren për tetë tematika.

### NESSTAR

Paketa e ESS Online Analysis përdor programin NESSTAR, që është një instrument për analizën e të dhënave online, dokumentacioni mbështetës i së cilës gjendet në Institucionin e të Dhënave të Shkencave Sociale të Norvegjisë ([www.nesstar.com](http://www.nesstar.com)).

Qëndrimet e publikut janë të rëndësishme në shoqëritë demokratike. Ato pasqyrojnë besimet, dëshirat, frikën dhe parapëlqimet e qytetarëve. Qëndrimet janë të vështira për t'u matur, nuk shprehen shpesh dhe ato nuk mund të deduktohen nga votimet elektorale. Ato as nuk mund të mblidhen nga sondazhet e mediave mbi opinionin, që anojnë drejt vështrimeve të çastit e të paplota mbi formimin dhe ndryshimin e qëndrimit të publikut. Sondazhi Social Evropian ofron të dhëna të hollësishme të qëndrimeve dhe sjelljeve të publikut duke përdorur metodologji të cilësisë së lartë shkencore e matje të përsëritura në kohë.

Seritë e raportimeve të SSE-s, të kryera nga ekspertë akademikë të mirënjohur të fushës, ofrojnë një prezantim të çështjeve kyçe të shoqërive evropiane. Raportimet shkojnë përtej një paraqitje të thjeshtë të të dhënave dhe ofrojnë referenca ndaj teorisë e analiza të hollësishme akademike. Këto seri raportimesh shpresohet të jenë jo vetëm jenë informative, por edhe që të frymëzojnë të tjerë të shfrytëzojnë këtë burim të pasur të të dhënave.

### Rory Fitzgerald

*Drejtori i SSE ERIC*

### Autorët e këtij edicioni janë:

Mónica Ferrin është studiuese pas-doktorate në Universitetin e Zyrihut, Zvicër.

Hanspeter Kriesi është Kryetari i Stein Rokkan i Politikës Krahasuese në Institutin e Universitetit Evropian, Firence, Itali.

Të dy këta akademikë ishin anëtarë të Ekipit të Hartimit të Pyetësorëve (EDP) të cilët zhvilluan modulën "Të kuptuarit dhe të vlerësuarit e demokracisë për evropianët". Anëtarët e tjerë të EDP-së ishin:

Leonardo Morlino, LUISS, Romë, Itali;

Pedro Magalhães, Universiteti i Lisbonës, Portugali;

Sonia Alonso, Universiteti Georgetown, Katar

Bernhard Wessels, Qendra Kërkimore e Shkencave Sociale, Berlin (WZB), Gjermani.

## Të kuptuarit dhe të vlerësuarit e demokracisë për evropianët

### Rezultatet kryesore nga raundi 6 i Sondazhit Social Evropian

**Mónica Ferrin dhe Hanspeter Kriesi**

#### Hyrje

Në Evropë, demokracia vlerësohet nga shumë njerëz si një vlerë universale dhe konsiderohet si sistemi më i mirë i mundshëm për të organizuar preferencat e qytetarëve. Megjithatë, njëkohësisht, ka shqetësime të mëdha në lidhje me pakënaqësinë në dukje të publikut mbi mënyrën se si funksionon aktualisht demokracia në shumicën e vendeve evropiane. Demokracitë evropiane po përballen me sfida serioze, të cilat mund të bjerrin besimin e qytetarëve në kapacitetin e demokracisë për të zgjidhur probleme të rëndësishme. Një nga sfidat e madhe është globalizimi dhe për pasojë erozioni i pushtetit të parlamenteve kombëtare përkundër organizatave ndërkombëtare si Bashkimi Europian dhe korporatat globale. Tjetër sfidë është edhe kriza e thellë ekonomike që ka goditur demokracitë evropiane në vitet e fundit.

Brenda këtij konteksti është e rëndësishme të kemi një panoramë gjithëpërfshirëse mbi qëndrimet të evropianëve ndaj demokracisë. A janë evropianët ende të përkushtuar ndaj demokracisë? Nëse po, çfarë mendojnë ata pikërisht se duhet të ofrojë demokracia? Në cilat aspekte të demokracisë në vendet përkatëse të tyre shprehin ata pakënaqësinë më të madhe? Deri më tani ka pasur mungesë të të dhënave të detajuara mbi qëndrimet e qytetarëve ndaj demokracisë në Evropë. Një seksion i ri i pyetjesh janë paraqitur në raundin e gjashtë të Sondazhit Social Evropian (SSE) ofron një mundësi për t'u drejtuar këtyre çështjeve.

Sondazhi paraqet një grup inovativ treguesish që kanë për qëllim të vlerësojnë domethënien që evropianët i veshin konceptit të demokracisë dhe si e vlerësojnë ata performancën demokratike të vendit të tyre. Raundi I 6 SSE u zhvillua fund të 2012 në 29 vende. Në këto vende u kryen rreth 54,600 intervista ballë për ballë të standardizuara, ku të përzgjedhurit nëpërmjet metodave rastësore të probabilitetit sigurojnë kampione përfaqësuese kombëtare të popullsisë. Secili vend e organizoi përkthimin dhe punën e vetë në terren sipas standardeve të përcaktuara nga Ekipi Shkencor Ekzekutiv i SSE-s<sup>1</sup>.

Ky raport paraqet gjetje kyçe për vendet pjesëmarrëse.<sup>2</sup> Këto përfshijnë vende nga katër zona të ndryshme gjeografike të Evropës: shtatë vende të Evropës Perëndimore: Belgjika, Franca, Gjermania, Irlanda, Holanda, Zvicra dhe Britania e Madhe; Pesë vende të Europës Veriore: Danimarka, Finlanda, Islanda, Norvegjia dhe Suedia; Katër vende të Evropës Jugore: Qipro, Itali, Portugali dhe Spanjë, plus Izraelin; Dhe dymbëdhjetë vende të Evropës Qendrore dhe Lindore: Shqipëria, Bullgaria, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Lithuania Polonia, Sllovenia, Sllovakia, Kosova, Rusia dhe Ukraina, këto vende ndryshojnë shumë si në aspektin e performancës demokratike edhe në lidhje me shkallën e goditjes nga kriza ekonomike. Kjo na lejon të hulumtojmë se, kur dhe pse mbështetja demokratike mund hasë vështirësi.

## Demokracia - një koncept shumë-dimensional

Edhe pse teoricienët politikë dhe qytetarët janë dakord që demokracia është për tu çmuar për hir të saj dhe në vetvete, shumë pak janë dakord mbi atë se çfarë është apo duhet të jetë demokracia. Prandaj dhe moduli i raundit 6 të ESS-së për demokracinë bazohet në një koncept shumë-dimensional të demokracisë, kryesisht mbi veprën e Morlino (2009) dhe Kriesi et al. (2013). Duke marrë parasysh idetë e shumta që njerëzit mund të kenë për demokracinë, ne e kemi zgjeruar konceptin e demokracisë për të përkrahur nocione që shkojnë tej modelit klasik liberal demokratik. Kësisoj, ne kemi bërë dallimin e 6 dimensioneve që synojnë kapjen e komponentëve të ndryshëm të demokracisë (shih Tabelën 1).

Dy dimensionet e para të paraqitura në Tabelën 1 përfshijnë elementet procedurale të modelit liberal demokratik: procesin zgjedhor me përbërësit e tij (dimensionin zgjedhor) dhe garancinë e mbrojtjes së qytetarëve ndaj vendimeve arbitrares të qeverive kundër njëra-tjetrës (dimensionin liberal). Dy dimensionet e tjera zgjerohen mbi këtë përkufizim klasik të demokracisë duke paraqitur dy modele shtesë. Modeli social i demokracisë ngarkon me përmbajtje thelbësore konceptin e demokracisë dhe shqyrton arritjen e rezultateve të caktuara sociale (p.sh. reduktimin e pabarazisë) si një tipar thelbësor i qeverisjes demokratike (dimensioni social).

Modeli i demokracisë direkte kundërshton modelin klasik liberal të përfaqësimit të demokracisë dhe përfshin idenë se njerëzve duhet t'u lejohet një pjesëmarrje e drejtpërdrejtë në vendimmarrje (dimensioni i drejtpërdrejtë i demokracisë). Përfundimisht, dimensionet e fundit të paraqitura në Tabelën 1 paraqesin mënyra të veçanta të institucionalizimit të demokracisë. Me dimensionin e gjithëpërfshirjes nënkuptohet shkalla e shtrirjes

së të drejtave dhe përgjegjësiive demokratike mbi të të gjithë popullsinë e banorëve ose nëse përjashtohen disa grupime të caktuara. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin evropian ku imigrantët përbëjnë gati 10% të popullsisë. Dimensioni i përfaqësimit dallon gjërisht ndërmjet sistemeve të shumicës që kanë tendencën të përqendrojnë pushtetin në duart e partive të vetme dhe sistemet proporcionale që tentojnë të çojnë në ndarjen e pushtetit midis palëve të ndryshme.

Për secilën prej këtyre nën-dimensioneve, në modulin e raundit 6 u paraqitën dy pyetje për të dalluar dy aspekte të ndryshme të qëndrimit të njerëzve ndaj demokracisë. Një pyetje merret me rëndësinë që njerëzit i japin secilës prej nën-dimensioneve të demokracisë, për shembull kuptimin që i atribuojnë demokracisë. Pyetja tjetër kishte për qëllim matjen e gjykimeve të njerëzve në lidhje me praninë e këtyre nën-dimensioneve të demokracisë në vendet përkatëse, për shembull vlerësimi i tyre mbi demokracinë. Për të shmangur trazimet ndërmjet pikëpamjeve të njerëzve mbi demokracinë si një ideal dhe gjykimet e tyre për funksionimin aktual të demokracive në vendet përkatëse, të anketuarit u pyetën së pari mbi rëndësinë e të gjitha nën-dimensioneve të demokracisë në përgjithësi dhe më pas iu kërkua ti vlerësonin ato në mënyrën sesi funksionojnë në vendin e tyre. Qëndrimet në secilin nën dimension janë matur në një shkallë nga 0-10, siç edhe tregohet më poshtë në Figurën 1 (me përjashtim të tre nën-dimensioneve të shënuara me një yll \* në Tabelën 1).<sup>iii</sup> Për mungesë së hapësirës, analiza që vijon përqendrohet mbi demokracinë zgjedhore, liberale, sociale dhe dimensionin e pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të demokracisë (duke përjashtuar nën-dimensionet e shënuara me yll).

Tabela 1: Dimensionet dhe nën dimensionet e demokracisë

DIMENSIONI ELEKTORAL	
Konkurenca	Zgjedhje të lira e të ndershme
	Ndryshimet e ofertave nga palët
	Liria që gëzon opozita për të kritikuar qeverinë
Llogaridhënia vertikale	Llogaridhënia retrospektive përmes zgjedhjeve
	Justifikimi për vendimet e marra sipas qeverisë
Diskutimi dhe shqyrtimi racional	Pjesëmarrja në diskutimet politike
Gatishmëria për të reaguuar	Gatishmëria për t'iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve*
	Gatishmëria për t'iu përgjigjur kërkesave të shteteve të BE-së

DIMENSIONI LIBERAL	
Shteti i së drejtës	Barazia para ligjit
Llogaridhënie horizontale	Ndarja e pushtetit dhe kontrolli ndaj qeverisë nëpërmjet gjykatave
Të drejtat e pakicave	Mbrojtja e të drejtave të pakicave
Liria e shprehjes	Liria e shprehjes së mendimit*
Liria e shtypit	Liria e medias
	Besueshmëria e mediave

DIMENSIONI SOCIAL	
Drejhtësia Sociale	Mbrojtja nga varfëria
	Zvogëlimi i shpërndarjes së pabarabartë të të ardhurave

DIMENSIONI I DEMOKRACISË SË DREJTPËRDREJTË	
Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë	Pjesëmarrja e qytetarëve nëpërmjet referendumeve


DIMENSIONI I GJITHPËRFSHIRJES	
Gjithpërfshirja	Gjithpërfshirja e së drejtës së pjesëmarrjes (të emigrantëve)

LLOJI I DIMENSIONIT PËRFAQËSUES	
Tipologjia e përfaqësimit	Maxhoritar ose proporcional*



Figura 2: Perceptimi mbi rëndësinë e jetesës në një vend demokratik




Burimi: Sondazhi Social Evropian Raundi 6, 2012

liberalët (Figura 4) dhe dimensionet sociale dhe të drejtëpërdrejta të demokracisë (Figura 5) e demokracisë, e përmbledhur nga rajoni. Këto shifra tregojnë se, pavarësisht se ku jetojnë, evropianët kërkojnë më shumë demokraci. Në të katër rajonet, mesatarja e pikëve në shkallën e rëndësisë ishte i barabartë ose më i lartë se 8 për shumicën e attributeve.

Për më tepër, duket se evropianët kanë një nocion të gjerë të demokracisë, i cili nuk kufizohet


vetëm në një konceptim thjesht procedural të demokracisë. Krahas rëndësisë së aspekteve kyçe procedurale të një demokracie liberale zgjedhore, siç janë zgjedhjet e lira e të drejta dhe barazia para ligjit, të anketuarit vlerësuan dimensionet e demokracisë sociale dhe të drejtëpërdrejta të demokracisë mesatarisht mbi 8, nga 1 në 10. Demokracia, sipas idealeve të evropianëve, supozohet të ketë një dimension social dhe t'u japë mundësi qytetarëve që të marrin pjesë drejtpërsëdrejti në vendimmarrje.

**Figura 3: Pikët mesatare të rëndësisë për dimensionin zgjedhor të demokracisë (0-10), sipas rajonit**



Burimi: Sondazhi Social Evropian Raundi 6, 2012


**Figura 4: Pikët mesatare të rezultatit të rëndësisë për dimensionin liberal të demokracisë (0-10), sipas rajonit**



Burimi: Sondazhi Social Evropian Raundi 6, 2012



**Figura 5: Pikët mesatare të rëndësisë së dimensioneve demokratike sociale dhe të drejtpërdrejtë të demokracisë (0-10), sipas rajonit**



Burimi: Sondazhi Social Evropian Raundi 6, 2012

Hulumtimi i mëtejshëm i qëndrimeve ndaj nën-dimensioneve të ndryshme të demokracisë lë të kuptohet se evropianët kanë një botëkuptim të qartë të asaj çfarë është demokracia (dmth. çfarë duhet të jetë e pranishme për ta identifikuar “demokracinë”) dhe se ky kuptim është në një masë të gjerë e ngjashëm në të gjitha vendet. Analiza jonë, e cila përqendrohet në ato karakteristika të demokracisë që prej të anketuarëve konsiderohen thelbësore, domethënë nën dimensionet që ata shënojnë 10 në shkallën 0-10 të rëndësisë, zbulojnë dy gjëra rreth kuptimit të të anketuarve për demokracinë.

Së pari, të anketuarit duket se dallojnë empirikisht midis tre aspekteve kryesore të demokracisë që korrespondojnë me modelet e ndryshme të demokracisë të identifikuar në Tabelën 1 më lart. Bazuar në analizën e shkallës Mokken të elementeve dikotomike të krijuara duke riformuar shkallët origjinale të 11 pikave si 1 ose 0, në varësi të faktit nëse i intervistuari e konsideronte secilin nën dimension si kusht të domosdoshëm për demokracinë (10 = 1) ose jo (0/9 = 0),

qëndrimet mund të grupohen empirikisht në tri tregues përmblidhës: indeksi i demokracisë liberale (që përmban elemente të dimensioneve liberale dhe zgjedhore të demokracisë), indeksin e demokracisë sociale (që përfshin dy elementet në dimensionin social) dhe indeksin e drejtpërdrejtë të demokracisë (që përfshin një artikull në dimensionin e drejtpërdrejtë të demokracisë).

Së dyti, nocioni Evropian i demokracisë renditet në mënyrë hierarkike. Evropianët i gjykojnë disa elementë të demokracisë më të rëndësishme se disa të tjerë. Jo të gjithë do të kishin kërkesa domosdoshmërisht të njëjta ndaj demokracisë; disa njerëz mund të zotërojnë një pikëpamje minimale ndaj demokracisë dhe të gjykojnë vetëm disa aspekte si thelbësore, ndërsa të tjerë mund të kenë kërkesa më të gjera.

Megjithatë, ata që janë më pak kërkues ndaj demokracisë, identifikojnë si të rëndësishme të njëjtat parime demokratike kyçe, si dhe ata me kërkesa më të gjera (që pastaj vendosin gjithashtu kërkesa shtesë për demokracinë). Për shembull, duke marrë parasysh 12 elementët e përfshirë

në indeksin e demokracisë liberale, shumica e të anketuarve, duke përfshirë ata që kanë një pikëpanje minimale të demokracisë, identifikojnë dy nën-dimensione si thelbësore për demokracinë - barazinë para ligjit dhe zgjedhjet e lira dhe të ndershme.

Ata që presin më shumë nga demokracia, gjithashtu gjykojnë edhe karakteristika të tjera si të nevojshme, duke përfshirë llogaridhënien horizontale, justifikimin e vendimeve të marra nga qeveritë e tyre, dhe besueshmërinë e mediave. Renditja hierarkike e elementëve të përfshirë në

**Tabela 2: Domethënia e demokracisë nga evropianët: Renditja e nën-dimensioneve që gjykojnë si thelbësore për demokracinë**

INDEKSI DHE SUBDIMENSIONET	E RENDITURA NË MËNYRË HIERARKIKE
<b>INDEKSI I DEMOKRACISË LIBERALE</b>	
Barazia para ligjit	1
Zgjedhje të lira dhe të ndershme	2
Kontrollet dhe ekuilibrat mbi pushtetit e qeverisë	3
Justifikimi i vendimeve nga qeveria	4
Besueshmëria e mediave	5
Llogaridhënia në retrospektivë me anë të zgjedhjeve	6
Mbrojtja e të drejtave të pakicave	7
Liria e mediave	8
Liria e opozitës për të kritikuar qeverinë	9
Ndryshimet mes palëve (partive)	10
Pjesmarrja në diskutimet politike	11
Gatishmëria për t'iu përgjigjur qeverive të tjera të BE-së	12
<b>INDEKSI SOCIAL I DEMOKRACISË</b>	
Mbrojtja nga varfëria	1
Zvogëlim i pabarazisë së të ardhurave	2
<b>INDEKSI I DEMOKRACISË SË DREJTPËRDREJTË</b>	
Pjesmarrja e qytetarëve nëpërmjet referendumeve	1

Burimi: Sondazhi Social Evropian Raundi 6, 2012


indeksin e demokracisë liberale është i ngjashëm në të gjitha vendet. Një analizë e përmblodhur e të gjitha 29 shteteve të Sondazhit Social Evropian e rendit “barazinë para ligjit” në krye sipas rëndësisë dhe “gatishmërinë për t’iu përgjigjur qeverive të tjera të BE-së” në fund (Tabela 2).<sup>iv</sup>

Megjithëse ekziston një nocion i përbashkët në vendet e anketuara- se nocioni i demokracisë është hierarkik dhe përfshin tre aspekte të dallueshme - të përfaqësuara nga demokracia liberale, demokracia sociale dhe indeksat përmbljedhëse të demokracisë së drejtëpërdrejtë - ekzistojnë dallime midis vendeve në aspektin e rëndësisë relative për secilën prej tyre. Figura 6 ilustron variacionet e mesatareve të pikëve nëpër shtete për secilën prej

indekseve përmbljedhëse. Këto masin shkallën e sa shumë thelbësore për demokracinë gjykohen për demokracinë nën-dimensionet që përbëjnë këto indekse. Në disa vende, njerëzit janë shumë kërkuar për demokracinë, duke parë elementët e të tre indekseve të demokracisë si thelbësore

Kjo vlen veçanërisht për Shqipërinë, Qipron, Bullgarinë dhe Kosovën. Në të kundërt, të anketuarit në vende të tjera si Holanda, Finlanda, Belgjika dhe Sllovakia janë shumë më pak kërkuar ndaj demokracisë dhe kanë më pak gjasa të marrin në konsideratë një nga tri aspektet e gjera të demokracisë si thelbësore. Në mes, gjejmë vende - si Gjermania dhe Suedia - ku njerëzit i shohin përbërësit e indeksit të demokracisë liberale si

**Figura 6: Mesatarja e pikëve përmbljedhëse në treguesit e rëndësisë (0-10), sipas vendit**



Burimi: Sondazhi Social Evropian Raundi 6, 2012

thelbësore, por jo, për shembull, atributet e indeksit të drejtpërdrejtë të demokracisë. Megjithatë, në shumicën e vendeve, rezultatet e ngjashme në secilin indeks sugjerojnë që njerëzit nuk i perceptojnë modelet e ndryshme të demokracisë si kontradiktore ose alternativa të njëri-tjetrit, por më tepër si plotësuese të njëra tjetrës.

**Vlerësimet e evropianëve ndaj demokracisë**


Duke i vështruar pikëpamjet e njerëzve në lidhje me kuptimin e demokracisë si një ideal, tani vijojmë të marrim parasysh sa larg mendojnë njerëzit se demokracia funksionon krahasuar me këtë ideal në praktikë. Figurat 7 deri 9 tregojnë vlerësimet mesatare të nën-dimensioneve të ndryshme të demokracisë në të katër rajonet evropiane.<sup>v</sup>

Një rezultat i parë që del në pah, janë vlerësimet e sa zbatohen atributet e ndryshme të demokracisë

në praktikë, këto janë përgjithësisht shumë më të ulëta se mbështetja për atributet e ndryshme si karakteristika të rëndësishme të një demokracie ideale (tregohet në figurat 3 deri në 5).


Demokracitë evropiane duket se nuk përmbushin pritshmëritë e qytetarëve të tyre në lidhje me idenë se si duhet të jetë demokracia. Kjo është veçanërisht e dukshme në dy anë, në lidhje me demokracinë sociale dhe atë të drejtpërdrejtë. Në të katër rajonet evropiane, dimensionet liberale dhe zgjedhore të demokracisë përgjithësisht vlerësohen më pozitivisht sesa dimensionet sociale dhe të drejtpërdrejta të demokracisë; dy pikat në dimensionin social marrin pikë mesatare prej vetëm 6 në 10 ose më poshtë në të gjitha rajonet, ndërkohë që pyetja e referendumit që përfaqëson dimensionin e drejtpërdrejtë të demokracisë merr vlerësime mesatare nën 6 pikë kudo përveç se në Evropën Veriore.

**Figura 7: Vlerësimet mesatare të dimensionit zgjedhor të demokracisë (0-10), sipas rajonit**




Burimi: Sondazhi Social Evropian Raundi 6, 2012

Figura 8: Vlerësimet mesatare të dimensionit liberal të demokracisë (0-10), sipas rajonit



Burimi: Sondazhi Social Evropian Raundi 6, 2012

Figura 9: Vlerësimet mesatare të dimensioneve demokracive sociale dhe të drejtëpërdrejta të demokracisë (0-10), sipas rajonit



Burimi: Sondazhi Social Evropian Raundi 6, 2012


Figurat 7 deri 9 tregojnë gjithashtu se ekziston një ndryshim i ndjeshëm në vlerësimet sipas rajoneve. Natyrisht, më të kënaqurit me funksionimin e demokracive të tyre janë evropianët e veriut, të ndjekur nga evropianët perëndimorë, ndërsa vlerësimet e demokracisë nga ana e evropianëve jugorë dhe atyre qendrorë mbesin prapa. Ky model i variacionit rajonal është në një masë të gjerë i njëjtë për të gjitha nën-dimensionet.

Figura 10 ofron më shumë informacion se si vlerësimet ndaj demokracisë ndryshojnë në vende të ndryshme. Tre tregues përmblidhës të vlerësimit janë ndërtuar bazuar në dallimin teorik

midis demokracisë liberale, sociale dhe direkte të miratuar më parë. Rezultati në çdo indeks ofron vlerësimin mesatar të të gjitha nën-dimensioneve që përbëjnë atë indeks.

Vetëm katër vende shënojnë nën 5 në indeksin e vlerësimit të demokracisë liberale: Ukraina, Rusia, Italia dhe Kosova. Kjo tregon se shumica e demokracive evropiane duket të veprojnë relativisht mirë përse i përket tipareve themelore procedurale të demokracisë zgjedhore dhe funksionimit të institucioneve liberale demokratike; Ato vlerësohen më pozitivisht sesa negativisht, edhe pse vetëm në disa vende.

**Figura 10: Mesatarja e pikëve në indekset përmblidhëse të vlerësimit (0-10), sipas vendit**



Burimi: Sondazhi Social Evropian Raundi 6, 2012


Krejt ndryshe, ndodh me indeksin e vlerësimit të demokracisë së drejtpërdrejtë dhe, edhe akoma më dukshëm, me indeksin i demokracisë sociale, ku nuk arrijnë asnjë rezultat mesatar prej 5 në shumicën e vendeve. Duke pasur parasysh se këto dy dimensione gjithashtu gjejnë përkrahje të fortë midis evropianëve si të rëndësishëm për demokracinë, ka një dështim të dukshëm të qeverive demokratike për të përmbushur pritjet e publikut.

### Marrëdhënia midis qëndrimeve ndaj demokracisë dhe performancës demokratike dhe ekonomike në Evropë


Si ndërlidhen qëndrimet ndaj demokracisë, matur nga ESS-ja me masat e përcaktuara të performancës demokratike? Ne do të prisnim që pritshmëritë e qytetarëve dhe vlerësimet e demokracisë varen nga mënyra se si demokracitë punojnë në praktikë. Vlerësimet e demokracisë lidhen domosdoshmërisht me performancën demokratike.

Përveç kësaj, kuptimi që njerëzit i japin demokracisë, dmth. ajo që presin të ofrohet nga një demokraci ideale, ka të ngjarë të varet nga konteksti: njerëzit mund të jenë më kërkues për atë që demokracia duhet të ofrojë nëse

**Figura 11: Korrelacioni ndërmjet botëkuptimit lidhur me demokracinë (indeksi i demokracisë liberale ESS: rëndësia) dhe performancës demokratike (Treguesit e Bankës Botërore të cilësisë së qeverisjes)**



**Figura 12: Korrelacioni ndërmjet vlerësimeve të demokracisë (indeksi i demokracisë liberale ESS: vlerësimi) dhe performancës demokratike (treguesit e Bankës Botërore për cilësinë e qeverisjes)**



Burimi: Sondazhi Social Evropian Raundi 6, 2012

demokracia e tyre është duke funksionuar mirë, duke rritur pritshmëritë në atë çfarë mund të jetë e mundur ose, përndryshe, qytetarët mund të jenë më kërkues në demokracitë më pak të zhvilluara, pikërisht për shkak se ata perceptojnë pasojat e një mungese në demokraci.

Figura 11 mbështet pjesërisht hipotezën e dytë; korrelacioni midis qëndrimeve të njerëzve në lidhje me kuptimin e demokracisë të matura nga indeksi i demokracisë liberale të ESS-së dhe treguesit përmbledhës të Bankës Botërore të cilësisë së qeverisjes<sup>vi</sup> është negative ( $p = -0,48$ ). Publiku duket se është më kërkues në lidhje me demokracinë në vendet ku cilësia e qeverisjes është e ulët. Në të kundërt, në demokracitë që funksionojnë mirë, njerëzit janë më pak kërkues ndaj saj.


Sipas hipotezës së sipërpërmendur, ekziston një marrëdhënie pozitive ndërmjet treguesve

të përcaktuar të performancës demokratike dhe vlerësimeve personale të evropianëve për sistemet e tyre demokratike në indeksin e demokracisë liberale të ESS (Figura 12). Korrelacioni mes tyre është mbi 0.90, gjë që tregon se publiku përbën një burim të besueshëm për vlerësimin e cilësisë demokratike dhe mund të ofrojë një burim të vlefshëm informacioni shtesë mbi ato aspekte të demokracisë të cilat kanë nevojë për përmirësime në një vend.

Vlerësimet e njerëzve mbi zhvillimin pozitiv të demokracisë në vendin e tyre gjithashtu priten të lidhen statistikisht me ecurinë ekonomike, me njerëzit që kanë më shumë gjasa të mbajnë vlerësime më pozitive të demokracisë dhe mënyrën se si qeveria e tyre qeveriset kur ajo ofron prosperitet ekonomik (shih, për shembull, Anderson dhe Guillory 1997).



**Figura 13: Korrelacioni ndërmjet vlerësimeve të demokracisë (indeksi i demokracisë liberale ESS: vlerësimi) dhe ecurisë ekonomike (ndryshimi i rritjes mesatare të PBB 2005/08 - 2009/12)**



Burimi: Sondazhi Social Evropian Raundi 6, 2012

Figura 13 ilustron marrëdhënien ndërmjet rritjes ekonomike (matur nga ndryshimi në rritjen mesatare të GDP-së 2005/08 - 2009/12)<sup>vii</sup> dhe vlerësimet e demokracisë të matura nga indeksi i demokracisë liberale ESS. Kjo konfirmon se ka një raport pozitiv ndërmjet performancës ekonomike dhe vlerësimeve të demokracisë ( $\rho = 0.49$ ). Megjithatë, është e dukshme që korrelacioni ndërmjet vlerësimeve të njerëzve të regjimeve demokratike dhe treguesve të performancës ekonomike është më i dobët sesa korrelacioni ndërmjet vlerësimeve të njerëzve dhe treguesve të përcaktuar të performancës demokratike.

Këto të dhëna sugjerojnë që, përsa kohë që ekonomia luan një rol, mirëfunksionimi i institucioneve dhe procedurat demokratike në praktikë janë edhe më të rëndësishme për perceptimin e publikut mbi demokracinë. Kjo gjetje mund të inkurajojë demokracitë evropiane sa i përket krizës së fundit ekonomike.

## Përfundime

Moduli i raundit të gjashtë të ESS-së për qëndrimet ndaj demokracisë ofron një panoramë të detajuar të qëndrimit të evropianëve ndaj demokracisë. Demokracia si një ideal mbështetet shumë nga publiku në pothuajse të gjitha vendet e ESS. Për më tepër, publiku në përgjithësi ka një koncept të gjerë të demokracisë dhe e gjykon të paktën mjaft të rëndësishme që demokracia të realizojë objektiva sociale dhe të ofrojë shanse për pjesëmarrjen e qytetarëve, sikur është edhe pëmbushja e kërkesave themelore procedurale të zgjedhjeve të lira e të drejta dhe barazia para ligjit.

Megjithatë, domethënia që njerëzit i atribuojnë demokracisë dhe formave të demokracisë që mbështetin, varion brenda vendit dhe ndërmjet vendeve; ka dallime në lidhje me tiparet që njerëzit i gjykojnë thelbësore për demokracinë.

Ndërsa disa evropianë kanë një koncept më të kufizuar të demokracisë - duke theksuar vetëm disa aspekte procedurale të demokracisë, siç janë zgjedhjet e lira dhe të ndershme, të gjykuara thelbësore për demokracinë - të tjerë kanë një nocion më të gjerë se çfarë duhet të jetë demokracia, duke përfshirë këtu disa modele teorike të demokracisë: modeli liberal, modeli social dhe modeli i demokracisë direkte.

Lidhur me vlerësimin se sa mire demokracia gjykohet të funksionojë në vende të veçanta, raundi 6 i studimit të ESS-së siguron të dhëna të paçmueshme dhe të sakta rreth perceptimeve të evropianëve për demokracinë e vendeve të tyre. Të dhënat tregojnë se vlerësimet e performancës aktuale demokratike në shumicën e vendeve janë relativisht të ulëta dhe se demokracia në të gjitha vendet nuk i plotëson pritshmëritë e qytetarëve për atë se çfarë duhet të jetë ajo. Megjithatë, përtej fushëveprimit të këtij raporti, këto rezultate tregojnë

se një vështrim i kujdesshëm në vlerësimet e publikut për aspekte të ndryshme të demokracisë, mund të ndihmojë në identifikimin e çështjeve kryesore që duhet të shqyrtohet nga demokracitë e vëzhguara në Sondazhin Social Evropian.

Së fundmi, gjetjet nga ESS tregojnë se, performanca demokratike është më e rëndësishme se ecuria ekonomike në përcaktimin e qëndrimeve ndaj demokracisë. Kjo lë të kuptojë që kriza e fundit ekonomike në Evropë nuk duhet të ketë doemos pasoja negative për demokracinë. Gjithsesi, vetëm me këto të dhëna të mbledhura në një moment të caktuar, aktualisht është e parakohshme të jepet njëfarë sigurie për të ardhmen lidhur me angazhimin afatgjatë të evropianëve me demokracinë. Roli i ESS në monitorimin e çdo ndryshimi të ardhshëm në qëndrimet ndaj demokracisë do të jetë i një rëndësie të madhe.

## Referenca

'Institucionet Politike dhe Kënaqshmëria me Demokracinë: Një Analizë e Konsensusit dhe Sistemeve Maxhoritare në shumë shtete', i Revista e Shkencave Politike Amerikane 91 (1): 66. doi: 10.2307 / 2952259.

Kriesi, Hanspeter., Lavenex, Sandra., Esser, Frank., Bühlmann, Marc., dhe Daniel Bochsler. (2013) Demokracia në Epokën e Globalizimit dhe Mediatizimit, Palgrave Macmillan. <http://cadmus.eui.eu/handle/1814/25382>.

Morlino, Leonardo. (2009) 'Legjitimiteti dhe Cilësia e Demokracisë: Revista Ndërkombëtare e Shkencave Sociale (International Social Science Journal, 60 (196): 211–22. doi:10.1111/j.1468-2451.2010.01717.x).

## Shënime

<sup>i</sup> Hollësi të mëtejshme mbi SSE-në mund të gjenden në [www.europeansocialsurvey.org](http://www.europeansocialsurvey.org), përfshirë edhe të dhëna mbi vendet pjesëmarrëse, madhësitë e mostrave, pyetësorët dhe normat e përgjigjeve.

<sup>ii</sup> Analiza bazohet në mostrën e plotë të rreth 54,600 të anketuarve të moshës 15 vjeç e lart. Peshat e dizajnit të ESS janë aplikuar për analiza në nivel vendi; Si dizajni ashtu edhe pesha e popullsisë janë aplikuar për analizën në nivel rajonal.

<sup>iii</sup> Ne kemi përdorur një masë të ndryshme për këto tre pika për shkak të natyrës së tyre transaksionale: shumica vs. përfaqësimit proporcional; delegimi i përfaqësimit të besuar; dhe liria e shprehjes ndaj të gjithëve kundër asnjë lirie të shprehjes për pikëpamjet e patolerueshme.

<sup>iv</sup> Dy elementët që formojnë indeksin e demokracisë sociale janë gjithashtu të renditur hierarkisht. Mbrojtja nga varfëria ka gjasa të ketë përparësi ndaj elementëve të tjerë. Shumë të anketuar e shohin këtë si thelbësore, ndërsa në mes të tyre ka edhe nga ata që gjykojnë thelbësore edhe reduktimin e pabarazisë në nivelin e të ardhurave. Indeksi i demokracisë direkte përmban vetëm një element, kështu që nuk ka hierarki.

<sup>v</sup> Të intervistuarve nuk u është kërkuar të vlerësojnë nën-dimensionin e "Ilogaridhënies horizontale" (edhe pse ata e vlerësuan atë në aspektin e rëndësisë).

<sup>vi</sup> Mesatarja e gjashtë vlerësimeve probabilitare totale për vitin 2012: Kontrolli i korrupsionit; Efektiviteti i qeverisë; Stabiliteti politik; Stabiliteti rregullator; Qeverisja e ligjit; Zëri dhe përgjegjësia. Burimi: Treguesit Botërorë të Qeverisjes ([www.govindicators.org](http://www.govindicators.org)). Vlerat më të larta tregojnë qeverisje më të mirë.

<sup>vii</sup> Ndryshimi në rritjen mesatare të PBB-së (% vjetore) 2005-2008 krahasuar me 2009-2012. Burimi: Treguesit e Zhvillimit Botëror (<http://data.worldbank.org/indicator>).

# Rreth ESS

**Sondazhi Social Evropian është një sondazh i përdyvjeshëm i qëndrimeve dhe sjelljeve shoqërore i cili është kryer në 36 vende evropiane prej vitit 2001. Grupi i të dhënave përmban rezultatet e rreth 300,000 intervistave të përfunduara lirish të aksesueshme. Të gjitha sondazhet dhe dokumentacioni i lidhur me të nga ESS ERIC janë të disponueshme falas.**

## Temat që trajton ESS

- Besimi tek Institucionet
- Angazhimi në Politikë
- Vlerat social-politike
- Vlerat Morale dhe Sociale
- Kapitali social
- Përfjashtimi Social
- Identiteti kombëtar, etnik dhe fetar
- Mirëqenia, shëndeti dhe siguria
- Përbërja demografika
- Arsimi dhe profesioni
- Rrethanat financiare
- Rrethanat familjare
- Qasjet ndaj mirëqenies
- Besimi në institucionet e drejtësisë
- Qasjet dhe eksperiencat me rritjen e vjetërsisë
- Qytetaria, pjesmarrja në demokraci
- Imigrimi
- Familja, puna dhe mirëqenia
- Moraliteti ekonomik
- Organizimi i itinerarit të jetës

**Për më shumë në lidhje me ESS ERIC dhe qasjen në të dhëna [www.europeansocialsurvey.org](http://www.europeansocialsurvey.org)**

**Zbuloni më shumë rreth niveleve evropiane të mirëqenies në një faqe të krijuar posaçërisht nga ESS [www.esswellbeingmatters.org](http://www.esswellbeingmatters.org)**

**Ndiqeni ESS në Twitter [@ESS\\_Survey](https://twitter.com/ESS_Survey)**

**Bëjini like faqes [EuropeanSocialSurvey](https://www.facebook.com/EuropeanSocialSurvey) në Facebook**



Ky publikim ka marrë fonde nga Programi për Hulumtim dhe Inovacion i Bashkimit Evropian Horizon 2020 nën Marrëveshjen e Grantit 676166.

U botua nga Hulumtimi Social Evropian ERIC  
City, University of London  
Northampton Square  
London, EC1V 0HB  
United Kingdom  
+44 (0)20 7040 4901  
Maj 2017  
Dizajni original nga Rapidity

**ESS u nderua me statusin e Konzorciumit Evropian të Kërkimit të Infrastrukturalës (ERIC) në vitin 2013. ESS ERIC ka 14 Anëtarë (shtete) dhe 2 Vëzhgues.**

### Anëtarë:

Austria, Belgjika, Republika Çeke, Estonia, Franca, Gjermania, Irlanda, Lituania, Holanda, Polonia, Portugalia, Sllovenia, Suedia, Britania e Madhe.

### Vëzhgues:

Norvegjia, Zvicra.

### Pjesmarrës të tjerë:

Danimarka, Finlanda, Izraeli, Sllovakia marrin pjesë në Raundin e 7.

Grupet këshillimore shumëkombëshe në Asamblenë e Përgjithshme të ESS-së ERIC janë Bordi Këshillimor i Metodave dhe Bordi Këshillimor Shkencor. Ekipi Ekzekutiv i Ekspertëve të ESS ERIC përfshin GESIS, Mannheim; NSD, Bergen; Universiteti Pompeu Fabra, Barcelona; Instituti Holandez për Kërkime Sociale / SCP, Hagë; Universiteti Katolik i Leuven, Belgjikë; Universiteti i Ljubjanës. Forumi i Koordinatorëve Kombëtar përfshin Koordinatorëve Kombëtar të ESS nga vendet pjesëmarrëse.